

KOSOVARJA

Ballina: Blerina Selimaj - Kola
Foto: Fadil Berisha

**Ç'thotë
babai i
23 fëmijëve?**

**Shyqyr,
e kam burrin
të shkolluar,
jo politikan!**

**Kur
më braktise,
ta dita
kimetin!**

Blerina Selimaj - Kola
*grimerja që solli
trendin amerikan në Kosovë*

**Nora Istrefi,
a ka gjetur
të dashur?**

**Këngëtares
tona që kanë
fëmijë,
por nuk
dihet me kë**

**Pse spo jam
i pari
e as i treti,
por vetëm
i dyti!**

**Takimi i UB-së
me Ministrin
e Mbrojtjes,
z. Armend Mehaj**





DINO KERAMIKA

Kush Jemi Ne HISTORIA DHE FILOZOFIA

Kompania DINO filloi si një biznes individual në vitin 2000. Gjatë viteve, grupi ka ndërmarrë shumë projekte sfiduese dhe aftësi të akumuluar, njohuri dhe përvojë në krijimin e zgjidhjeve, shërbimet e menaxhimit të projektit, tregtinë e ndërtesave dhe punimet inxhinierike të ngjashme, shitjen e qeramikës, bluarja dhe shitja e gurit, si dhe furnizimet me energji. Kompania ofron një cilësi të lartë për klientët, pavarësisht nga sektori, duke provuar veten lider të industrisë gjatë viteve. Kompania prodhon të gjitha klasat e betonit sipas standardeve të ndërtimit, si dhe transportin në destinacionin përfundimtar, prodhimin e të gjitha fraksioneve të zhavorit, shitjen dhe transportimin në destinacionin përfundimtar, furnizimin e të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit, furnizimin e qeramikës. Shitje me shumicë dhe pakicë nga fabrikat më të njohura italiane dhe shitja e drejtpërdrejtë e lokaleve të biznesit dhe apartamenteve. Kompania është Partner i autorizuar për furnizim me keramike



Magjistralja Prishtinë-Ferizaj, Konjuh - 14000 Lipjan



+383 49 566 667



Dino Qeramika



www.dino-company.com

Veç kur më braktise, ta dita kimetin!

Isha ulur në atë tavolinën e tarracës, ku edhe pimë për herë të fundit kafe bashkë. Gjatë bisedës me mikun, me të cilin ishim ulur, m'u kujtuan fjalët tua të fundit që po aty m'i kishe thënë, dhe m'u duk sikur më kaploi një nostalgji.



Derisa rikujtoja ato momente, pa pritur u shfaqe para syve të mi, kur kalove andej pari për t'u futur në një dyqan të afërm. Nuk të kisha parë një kohë të gjatë, por vëreja se ti fare nuk kishe ndryshuar. Ishe po ajo bukuroshja e dikurshme, po ajo princesha e atëhershme.

Dhe, sa herë ulem aty rikujtoj fjalët tua që m'i kishe thënë dikur, moti, në atë vend, me të cilat ishte vulosur fundi i lidhjes sonë. Gjithmonë në ato momente më kaplon një nostalgji, një mall për të kaluarën, për ditët e bukura kur ishim bashkë.

Ajo ishte periudha e artë e jetës sime, e cila u ndryshua shumë prej se shkove ti, por në mua, çuditërisht, përgjithmonë mbeti ndjenja e fortë e dashurisë dhe admirimi për ty. Sot, pas kaq vitesh, përsëri u pamë po aty. Ti kishe ardhur prapa shpine,

duke ecur rrugës sate, por jam i sigurt se më kishe vërejtur që nga larg. Kur u afrova afër, u bërë se nuk më shihje dhe u fute në dyqanin që ishte pranë, karshi tarracës ku unë qëndroja. I befasuara humba përqendrimin, duke pyetur veten:

"A është e mundur që po e shoh?!".

Dhe, derisa ti bëje pazar në dyqan, unë vazhdoja të bëja muhabet me mikun, me të cilin ishim duke pirë kafe, e nga i cili fshehja shqetësimin tim, ani pse bota ime e brendshme ishte trazuar.

Në ato çaste m'u kujtua një moment interesant i së kaluarës, kur ne ishim në shpëputje e sipër të lidhjes sonë. Atëbotë, në bisedë e sipër, pas një reagimi spontan që kisha, e që shprehte një dozë xhelozie, më pate thënë: "Hë, unë ende qenkam pikë e dobët për ty!".

Dhe, pas kaq vitesh, sot, përsëri e vëreja se ti, vërtet, ende vazhdon të jesh pikë e dobët për mua...

TË HUMBA PËRGJITHMONË

Ti bukur shumë u vonove në dyqanin ku kishe hyrë. Nuk e kam idenë se çka ke mundur të blesh, por gjatë gjithë kohës sa qëndrova aty, sytë e mi nuk u shpëputen nga dera e atij dyqani ku ishe.

Dhe, duke pritur momentin e daljes sate, në një çast, vëreja se nga bren-dia e dyqanit i kishe drejtuar sytë kah unë. Atëherë në gjoks tim ndjeva një rrahje aritmike të zemrës...

Nuk di pse m'u ndezë flakë zemra për ty, por e di se fajtori për ndarjen tonë isha unë. Unë isha cikërrimtari grindavec që bezdisja jetën tënde, pa pasur mirëkuptimin e duhur për ty, duke shprehur xhelozinë e panevojshme vend e pavend.

Unë isha ai që dikur kisha pushtuar zemrën tënde, por që dalëngadalë dola nga ajo zemër për shkak të arrogancës sime.

Më pastaj, gabim pas gabimi, në stilin: "Çka t'i bësh dikujt ta bën tjetri", t'i bëra një mijë të pamira, duke lënduar shumë herë zemrën tënde.

Dhe, atëherë, kur mbeta pa ty, e kuptova peshën e fajeve të mia, nga pasojat e të cilave mbeta i vetmuar, me gishta në gojë, kur të humba përgjithmonë...

P. K.



Në ballinë

**Kush është grimerja që solli
*trendin amerikan të grimit në Kosovë***



Pasioni për grimin shihet në rezultatin e çdo kliente e cila futet në duart e saj.

Grimerja Blerina Selimaj - Kola e cila u kthye nga Amerika dhe hapi sallonin e bukurisë në Kosovë solli frymën amerikane të bukurisë dhe teknikat që vazhdojnë të jenë në trend edhe sot e kësaj dite.



Me profesion është psikologe por talenti për grim bëri që karriera e saj të merr kahje tjetër.

Sallonin InaBeauty në Prishtinë e hapi para 2 viteve, e që ofron shërbime të grimit, thonjve dhe flokëve.

Shumë fytyra publike kaluan në duart e saj ku vërtetë se rezultatet lënë pa koment.

Madje për klientët, Blerina thotë se janë motivi më i madh për punën e saj dhe se ndjehet falënderuese pa masë.

Me që kërkesat për shkollën e grimit janë të shumta, ajo planifikon që së shpejti të hapë akademinë ku të gjithë ata që dëshirojnë ta ndjekin rrugën e njejtë, një ditë të arrijnë qëllimin.

@inabeauties, faqja në Instagram ku do të gjeni detajet rreth teknikave që Blerina solli e para në vendin tonë, bën të shihet qartë dashuria për punën që bën.

Vlen të përmendet fakti se të gjitha

produktet që ajo përdorë për grim janë nga brendet e njohura botërore të blera në SHBA, gjë që tregon cilësinë dhe atë më të rëndësishmen, kohëzgjatjen e grimit.

Me që po afrohet sezoni i dasmave, maturanëve dhe ahengjeve të ndryshme, rezervoni terminin tuaj në +38344848000 ku mund t'i kryeni të gjitha shërbimet e bukurisë në një vend, pikërisht në Ina Beauty.

A.D.

Me çiftin që pret të martohet...

“Kur të bëhet liberalizimi i vizave do të shkojmë në muajin e mjaltit!”

Në bisedën e zhvilluar me çiftin e dashuruar, Elifen dhe Valin, nga Klina, studentë në Prishtinë, e që janë në lidhje që tre vjet, kuptuam anët pozitive dhe ato negative që mund të sjellë një lidhje e gjatë prej tre vjetësh. Biseda rrodhi spontanisht, e që e bëmë teksa pinim kafe te “Santeja” në Prishtinë.



Si u njohët?

Vali: - Jemi njohur një vit para se të fillojë pandemia. Ishte viti i parë i studimeve. Njohja ndodhi spontanisht, meqë banonim në konvikt përballë njëri-tjetrit. Kontakti ynë i parë ka ndodhur nëpërmjet dritares, ku unë, si djalosh komunikativ, mundohesha të krijoja njohje të reja me fqinjtë e objektit ku banoja.

Si e keni filluar bisedën për herë të parë?

Elifja: - Eh, më kthyet në kohën e njohjes, kur edhe sapo e paskam larguar nga mendja. Mbase tingëllon qesharake, mirëpo gjithmonë kur dilja në dritare, Vali nga largësia më bënte komplimente, e herë-herë edhe më ngacmonte me fjalë.

A e dinë prindërit për lidhjen tuaj?

Vali: - E dinë motrat e mia se unë jam në lidhje dashurie. Pak a shumë e di edhe nëna ime...

Elifja: - Nga ana ime e dinë e gjithë familja. Mirëpo, asnjëra nga familjet tona nuk e dinë për bashkëjetesën tonë, sepse, duke marrë parasysh statusin studentor, mund të keqinterpretohet.

Cili paguan më shumë?

Elifja: - Meqë tashmë nuk banojmë në konvikt, por në një banesë private dhe bashkëjetojmë, mundohemi të dy të kontribuojmë njëjtë për gjërat që

na nevojiten. Por, meqë i dashuri im punon, ai e ka parasysh se ne jemi studentë dhe nuk mund t'ia dalim mbanë duke paguar vetëm njëri.

Cilat janë të mirat dhe të këqijat e bashkëjetesës?

Elifja: - E mira është se kohë të gjatë jemi pranë njëri-tjetrit, por që nuk u ikim dot grindjeve, sepse kalon në një rutinë të përditshme, ku më pas edhe imtësitë më të vogla mund të nxisin grindje.

Por, më duhet të cek edhe faktin se gjithmonë është e pranishme frika se mos do zbulohemi, duke marrë parasysh paragjykimet e bashkëjetesës që bëhen në vendin tonë.

Vali: - Për mua e mira e bashkëjetesës është se kemi arritur të njihemi shumë mirë ndërmjet veti, kemi fituar shumë stabilitet në lidhjen tonë, meqë janë shmangur të gjitha dyshimet e mundshme nga të dy anët.

Mirëpo, siç e ceku edhe e dashura ime, ndonjëherë nuk u ikim dot grindjeve...

Kur do të martoheni?

Elifja: - Po presim liberalizimin e vizave që të shkojmë në muaj të mjaltit në Veronë të Italisë, në vendin e dashurive të mëdha, siç kam lexuar nga letërsia botërore...

Paçi fat!

Vali-Elifja: - Faleminderit!

D. Gj.

MË SHKOI JETA DUKE PRITUR!



“Sot qenka ditë e vranët, me riga shiu.
Druaj mos s’do gjej asnjë punë...
Deri kur kështu i papunë?
U plaka duke pritur se do të bëhet mirë!
Të faleminderit o Zot që na dhe lirinë, por
bën diçka me pushtetarët tanë që të men-
dojnë e punojnë pak edhe për ne, fukaren-
jtë, e jo sall për vetë!”
Janë këto fjalë të një punëtori krahu, të cilit
i ka mbetur pak shpresë për të nesërmen...
Sa jemi, por edhe a po jemi të vetëdijshëm
se populli shqiptar i Kosovës, brenda ditës,
afro 60 për qind e tyre, jetojnë vetëm me
70 centë në ditë?!
Kështu, së paku, lexojmë në opinione të
ndryshme të të përditshmeve, e edhe
nëpër portale tona, por edhe në debate kur
bisedohet për problemin e papunësisë...
E ne, jo se angazhohemi për zgjidhjen
e këtij problemi, së pakut për zbutjen e
tij, por shahemi, përlahemi, akuzojmë
njëri-tjetrin, madje edhe në atë masë sa
mungon edhe kriteri njerëzor! Harrojmë
përgjegjësinë që e kemi ndaj kombit, ndaj

vendit që e quajmë Atdhe.
Kush prej nesh ka menduar se do t’vjen
kjo ditë, që s’di njeriu ta emërojë, pos –
ditë e keqe? Pse kaq keq i shembim edhe
elementet e zakonet tona kombëtare që
na i kishin lakmi shumëkush?
Me një fjalë, po i shembim vlerat tona
kombëtare...
Kanë, ndoshta, të drejtë ata që thonë se
përditë jemi duke gropuar e hapur varre të
vetvetes.
E di se ka të atillë që s’pajtohen me këto
fjalë jo vetëm t’më. Do thonë se nuk është
kaq zi, as kaq keq. Por, e di edhe se shu-
mica do pajtohen, bile ata që jetojnë me
70 centë në ditë...

*

Ndoshta e pavend kjo thënie e moçme, por
e vlen të përmendet e t’mbahet në mend:
“Njerëzit mund ta kalojnë një oqean pa i
lagur këmbët, por nuk mund ta kalojnë
kurrë jetën e tyre pa i lagur sytë!”

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:
Gani DILI

Redaktor përgjegjës:
Isa ILAZI

Menaxher:
Driton DILI

Redaksia:
Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Rilinda Krasniqi
Ardita Dili

Dizajni:
Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë
Tel: 038 51 75 75
Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:
Tel: +383 44 143 448;
Email: marketing@kosovarja-ks.com



Ç'thotë babai i 23 fëmijëve?

Druari i Vushtrrisë, vendbanim me rreth 300 shtëpi, njihet si një prej fshatrave patriotike të kësaj komune, në të gjitha valët e jetës kundër Serbisë. Më 1999 i kishin djegur rrafsh me tokë shtëpi më shtëpi dhe për kuriozitet, si rrallë kund në Kosovë, serbët ishin përkujdesur që edhe hunjtë e gardhit të digjen, e të mos mbetët gjë në këmbë... Në familjen Bojku, i vëllai i Hajzerit, Aliu, ra dëshmor dhe një rrugë e Druarit mban emrin e tij "Ali Bojku". E Hajzer Hysen Bojku, në kohën kur e vizituam më 2017, ishte babai i 23 fëmijëve...

Hajzer Bojku, nga Druari i Vushtrrisë, është baba i 23 fëmijëve. 18 i ka gjallë, ndërsa pesë i kanë vdekur. Statistikisht është i treti në Kosovë për nga numri i fëmijëve. I pari, me 32 fëmijë, është nga komuna e Prishtinës, i dyti, me 26 fëmijë, është nga fshati Harilaç i Fushë-Kosovës, dhe, i treti, me 23 fëmijë, është Hajzer Bojku, nga Druari i komunës së Vushtrrisë.

Hajzer Bojkun nuk është zor ta gjesh në Vushtrri. Më zor është ta gjesh në shtëpinë e tij, në Druar, ku nuk rri

gjatë ditës. Ai del në mëngjes nga shtëpia për në Vushtrri, për t'u kthyer në mbrëmje. Burri shtatgjatë e me plis, me qystek ore të xhepit, me stil "allaturka", është i njohur në Vushtrri. E njohin të gjithë, meqë ditën e kalon me shokë të brezit të vet në çajtoret afër "Xhamisë së Çarshisë" në Vushtrri. Ai falë drekën në xhami dhe para se të bie mbrëmja niset për në katund, ku e ka shtëpinë.

Duke folur për jetën e vet, peripecitë dhe vuajtjet, ai thotë:

"I kam mbushur 92 vjet. Shikoni gishtërinjtë e mi, m'i kanë paralizuar serbët para luftës së vitit 1999. Policët më dërguan në stacionin policor në Vushtrri dhe më rrahën aq sa mezi mbeta gjallë. Nga pasojat e asaj rrahjeje katër gishta më kanë mbetur të shtangur dhe nuk mund t'i drejtoj, sepse është shkatërruar sistemi nervor i tyre.

Më rrahën për të vetmin qëllim: pse kisha bërë shumë fëmijë... se me fëmijë do i rezistoj Serbisë...

Në fakt, nuk është bash pa bazë ajo që thoshin serbët, por sa herë më mëshonin më thoshin çka të janë dashur 23 fëmijë... I frikësonte numri i madh i fëmijëve të mi, edhe pse jeta me fëmijët e mi e ka një anë tragjike me tri gra, dy prej të cilave më kanë vdekur”, thotë plaku pedant nga pamja dhe gardëroba, për të kaluar te arsyet historike se kush ishte familja Bojku nga Druari”.

MË 1941 SERBËT VRANË 3 SHQIPTARË PËR 1 SERB!

Dhe, duke treguar historikun familjar, ai thotë:

“Në vitin 1941, në oborrin e shtëpisë sonë, mbetën të vranë 28 kufoma. Kur hynë serbët në shtëpi më 1941, ne i vramë shtatë prej tyre. Më pas push-teti serb dërgoi përforsim dhe, kur ata u futën në oborrin tonë, erdhën me një vendim të prerë: Tre anëtarë të familjes sonë do i vritnin për një serb, që e kishim vranë në oborrin tonë. Në këtë mënyrë, zgjodhën 21 anëtarë të familjes dhe i pushkatuan në oborrin e shtëpisë sonë. Di se aso kohe mbetëm diku vetëm katër anëtarë dhe shtëpia u pakësua nga familja. Tani familja ime jemi 86 anëtarë, e që është për lakmi...”

Më kanë rrahur edhe në kohën e Rankoviqit. Familja jonë: katragjyshi, babagjyshi dhe babai im kanë vdekur nga plumbi i serbit! Më rrahën se kemi qenë familje në zë për vrasje me serbët në luftëra dhe në kohë të trazuara.

Në kohën e Jugosllavisë kemi qenë të izoluar krejt familja. Nuk kemi pasur të drejtë as të votojmë! Jo që donim të votonim, sepse nuk kishim për kë të votonim pos për ata që ishin me Serbinë... Nuk na kanë lënë të shkollohemi më shumë se me katër vjet shkollë, aq sa i kam edhe unë. Ne kurrë nuk kemi punuar në punë të shtetit, por me lopatë e punë të tjera fizike.

Kam qenë edhe pjesëmarrës i Aradhes së Shaban Polluzhës, e që bëri histori, duke mos pranuar urdhrin e komunistëve.

Pra, isha në sy të serbëve dhe na e njihnin historikun e familjes sonë

nga Druari. E kisha vështirë të dilja në Vushtrri prej tyre, sepse më njihnin kudo që shkoja”.

VËSHTIRË KAM JETUAR, VËSHTIRË JETOJ PËRSËRI!

“Por, çuditërisht, edhe sot askush nga familja ime nuk gjen punësim në organet shtetërore. Në shtëpinë time sikur po ndodh një izolim dhe diskriminim i dytë. Edhe sot punojmë punë fizike, kështu që të rinjtë e familjes sonë ikin jashtë...”

Pra, vështirë kam jetuar dhe vështirë jetoj përsëri! Nuk i kam punët mirë aspak”, ankohet Hajzeri dhe nxjerr nga xhepi paratë e imta për të paguar tre çaja, duke thënë se kemi para sa për çaj...

PSE U MARTUA 3 HERË?

Ai ndalet edhe te momentet e jetës së tij martesore. Tri herë i martuar në jetë, flet për të gjitha...

“Jam martuar me gruan e parë dhe me të i pata tre djem, të cilët më vdiqën, ku pas tyre vdiq edhe gruaja. Pata shumë dhimbje, sepse nuk arrita ta rris shtëpinë që më kishte mbetur e zbrazët...”

Pastaj, e mora gruan e dytë dhe me të pata gjashtë djem e një vajzë. Por, fati nuk deshi të plakemi bashkë, sepse edhe ajo vdiq, aksidentalisht nga vetëtima.

Me gruan e tretë i kam 12 fëmijë. Dal çdo ditë në Vushtrri, sepse në fshat nuk kam me kë me ndenjtë. Këtu i fali edhe vaktet në xhami dhe krejt kjo po më bën të ndihem mirë, ani pse i kam mbushur 92 vjet. Ndonëse shëndeti po më shkon ende mirë, kam këtu mjaft moshatarë me të cilët e kalojmë ditën

bashkë”, thotë ai.

Megjithatë, xha Hajzeri më shumë flet për praninë e tij në Aradhen e Ballit Kombëtar si ushtar i devotshëm i Shaban Polluzhës, për të cilin thotë se i ka ndenjur afër deri në vdekjen e tij nga plumbi.

“Jam kyç në radhët e Ballit Kombëtar prej formimit të Brigadës së Shabanit. Aso kohe kemi jetuar në Pol-luzhë, te nipat, te Sylejman Kastrati, sepse shtëpitë na i patën djegur dhe s’kishim ku të rrinim. Sylejmani dhe Shabani baballarët vëllezër i kanë pasur. Baba im, Hysen Bojku, ka qenë udhëheqës i Ballit për rrethinën e Çiçavicës.

Pas lufte, sa herë ka ardhur ndonjë udhëheqës i lartë nga Jugosllavia në Kosovë, më kanë mbajtur nga 15 ditë në burg. Deri me ramjen e Rankoviqit, në familjen tonë nuk kemi pasur të drejtë as vote, madje as femrat se lëre më meshkujt...

Në vitet 90 aq shumë ma shtruan zullumin sa gati më mbytën... Kam ikur dhe kam shkuar në Suedi. Atje qëndrova tre vjet dhe mendova se u qetësua situata sado pak, por kur erdha ishte njëjtë...

Tash, e që jetojmë në liri, për dikë nuk është keq, por për dikë ende po... Asnjë nga familjarët e mi nuk punon në punë shteti, ani pse jemi 86 anëtarë të familjes”, tha në fund të bisedës sonë Hajzer Bojku, babai i 23 fëmijëve, e që mund të merret si krenaria e Kosovës...

Safet Krivaça





Unioni i bizneseve Shqiptaro-Gjermane

Takimi i UB-së

me Ministrin e Mbrojtjës, z. Armend Mehaj

Në Frankfurt u takuan përfaqësuesit e Unionit, nga Kryesia, kryetari Nazmi Viqa, drejtori i financave Vllaznim Kelmendi, sekretari Nexhmedin Veliqi; koordinatorët Besim Preniqi dhe Advan Cakiqi; anëtarët e Unionit Remo Rashica dhe Gazmend Kelmendi me Ministrin e Mbrojtjës, z. Armend Mehaj.



Disa prej temave diskutimi ishin ushtria dhe Fondi i Sigurisë, tema që preokupojnë aktualisht gjithë shoqëri-


në e Kosovës. Vëmendje e veçantë ishte domosdoshmëria e angazhimit i gjithë spe-

krit shoqëror në temat e sigurisë kombëtare si bazë e zhvillimit të sigurtë të shoqërisë dhe ndërtimit shtetëror.



remos[®] KA PUNË PËR TY!

Çka ne po kërkojmë është: **Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier**



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja:
**Frankfurt, Köln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.**

Na kontaktoni në info@remos-restaurants.de



Të dielën, më 24 prill, nën një klimë të përzier ambianti malor, bjeshkët e Belegut të Deçanit e bëjnë krenar jo vetëm Deçanin, por edhe Kosovën...

Njerëz të shumtë në të gjitha anët, qarkullojnë në rrugët e ngushta me shumë kthesa, që çojnë nëpër vila të ndryshme, ku kalohet, zakonisht, vikendi. E, kjo ka marrë dhenë sidomos viteve të fundit, kur malet e Belegut po bëjnë nam në turizmin vendor.

Ç'THOTË FAZLIU, 72 VJEÇ?

Fazliu, 72 vjeç, që kishte ardhur për vikend këtu nga Prishtina, në ndejë

Pse nuk ia dimë Zotit shyqyrin çka na ka dhënë?

rasti thotë:

“Është mëkat të mos vizitohet kjo bukur qe e ka krijuar Zoti! Për kuriozitet, ky vend ndodhet në trekëndëshin Kosovë-Mali i Zi-Shqipëri”, thotë ai. Në Beleg thonë se shteti duhet të ndikojë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, që ende është e pamjaftueshme për vizitorët e shumtë. “Duhet të ketë investime të shtetit këtu, sepse në dy-tre vjetët e fundit ka shumë turistë të jashtëm që qen-

drojnë këtu edhe me ditë të tëra.

Investimet e shtetit, por edhe të komunës, do sillnin shumë leverdi ekonomike, sepse do rritet buxheti dhe ato para do e forcojnë vendin tonë. Sidoqoftë, përfitimi nuk është vetëm ekonomik, por do shtohet edhe imazhi që të kemi sa më shumë vizitorë, qoftë vendorë, por edhe të jashtëm. Prandaj, është me shumë interes zgjerimi i rrugëve dhe rregullimi i tyre, në mënyrë që të ketë ndërtime vilash dhe motelesh”, thotë në vazhdim të bisedës sonë Ruhani, nga Peja, një nga banorët më të rregullt në këtë vend pitoresk.

BJESHKËT E BELEGUT ME SHTEG PËR KËMBËSORË

Bjeshkët e Belegut, me disa kilometra shteg për këmbësorë, vitin që shkoi është realizuar një grant qeveritar për investim turistik, që kapë shumë 250 mijë euro.



Por, ende është larg nevojës reale për ta ndryshuar gjendjen ekzistuese... Janë bërë edhe disa pika turistike në të cilat mund të vendosen vizitorët për qëndrime ditore.

E, ajo që e veçon këtë trevë është fakti se kudo gjejmë ushqime tradicionale, e që shfrytëzohen me të madhe nga vizitorët.

Në anën tjetër, për ata që duan natyrë origjinale, ujë ka me bollëk dhe të pastër si loti.

BUKURITË E BEKUARA...

Vizitorët e pasionuar me natyrën dhe ecjen në bjeshkë, thonë se në Beleg e gjejnë, si askund tjetër, një botë të veçantë malore, të ruajtur akoma me egërsinë e vet të paprekur nga dorë njeriu.

Me natyrë të pastër, që rrallë kund e gjen, bjeshkët e Belegut paraqesin shembullin më tipik për çaste të paharruara.

Në këtë vis kosovar vijnë vizitorë nga të gjitha anët e Kosovës dhe këtu gjejnë ajrin e pastër dhe të shëndetshëm për frymëmarrje.

Dhe, në një lartësi mbidetare prej 2000 metrash, bjeshkët e Belegut do të bëhen herë do kur urë lidhëse me Plavën dhe rajonin, duke nxitur edhe turizëm rajonal dhe qarkullim trafiku të shtuar.

Andaj, me të drejtë bjeshkët e Deçanit quhen "bukuritë e bekuara".



Në këtë natyrë të bukur, pra në Beleg, njohësit e bimëve shëruese i vjelin ato që me fillimin e pranverës dhe gjatë verës mbi 43 bimë shëruese, të cilat janë të njohura me shekuj në këto anë. Bimët, si Kantariumi, çaj mali, lëngu i trupit të drurit nga Breza, përdoren për shërim...

Sidoqoftë, hasëm në vende-vende edhe në borë, e cila është shtresuar në gropa të shumta të kësaj ane...

SI T'I RUAJMË BUKURITË NATYRORE ME VETËDIJE?

Për t'i ruajtur bjeshkët e Belegut, thotë bashkëbiseduesit, duhet investuar në ngritjen e vetëdijes dhe të shtohet

kujdesi institucional në raport me shtimin e kujdestarisë ndaj zjarreve verore, që po ndodhin shpesh, e që mund të bëjnë kërdi ekonomike.

"Njerëzit duhet t'i ruajnë bukuritë natyrore që na i ka falur Zoti, e jo të jenë shkatërrues të tyre!", thotë Dilaveri, 71 vjeç, nga Deçani, i cili thotë se një pjesë të madhe të verës e kalon në bjeshkët e Belegut.

Dhe, vonë pasdite, pas një dite të relaksuar në bjeshkët e Belegut, marrim rrugën për në Prishtinë, me mushkëritë e mbushura ajër të pastër të kësaj treve, që ka ditur vetëm Zoti i madhërisëm ta krijojë...

Safet Krivaça





Ina Beauty Center,

salloni që ofron të gjitha shërbimet e bukurisë



Që nga flokët e deri tek thonjtë, Ina Beauty ofron të gjitha shërbimet për gjininë e bukur.

Me pronare Blerina Selimaj - Kola, salloni u hap në vitin 2020 dhe ofron shërbime të shumta si: thonjtë, qerpikë, flokë, heqje e qimeve të padëshiruara me laser, microblading dhe gjitha shërbimet që do iu bëjnë të ndjeheni dhe dukeni bukur.

Shumë fytyra publike zgjedhin Ina Beauty për eventet e rëndësishme ndërkah nuk mungojnë terminet e shumta edhe në sezonin e dasmave dhe maturanteve.

Vlenë të përmendet se salloni përdorë make-up të markave më të njohura dhe kualitative duke bërë që grimi të

qëndrojë sigurt dhe klientet të ndahen të kënaqura.

Në @inabeauties në instagram do t'i gjeni të gjitha detajet, numrat kontaktues, imazhet dhe modelet e ndryshme, ku disa modele ishin nga fotosesionet e fotografit të njohur shqiptarë Fadil Berisha, e që ishte pikërisht Blerina që përkujdesej për pamjen e tyre.

Salloni ndodhet në rrugën Bardhyl Çausi në Prishtinë, ku vërtetë se po e vizituat njëherë do ndjeheni të veçantë dhe do ktheheni sërish në terminin e radhës.



Lagjja Eliza

Rr. Hamdi Grajdevci,
Fushë Kosovë



Vendi ku fillon një jetë e re!



Prishtinasi në Ksamil më bëri për vete!

Deri para më pak se një vit isha në lidhje dashuri me një djalë që e doja shumë, ama shumë... Edhe ai më donte... Por, si duket, fati ishte i tillë që ne të mos jemi gjithmonë bashkë. Pse?

Pata një lidhje të fortë dashurie me një djalë, e cila edhe mori fund para disa muajsh. 5 vjet i kaluam bashkë. E doja pa masë, por edhe më donte. Por, si duket, fati ishte i tillë që ne të mos jemi gjithmonë bashkë... siç kishim ëndërruar...

KSAMILI MA SHKATËRROI DASHURINË E VJETËR

Verën që shkoi isha me familjen time në Ksamil. Natyrë e mrekullueshme se jo mahi. Dolëm në plazh. Në plazh kishte edhe njerëz të tjerë, kryesisht të rinj... Laheshin, qeshnin dhe flisnin më zë të lartë. Më bezdisi ky fakt dhe mundohesha të mos i dëgjoj se ç'flisnin. Ua ktheva shpinën dhe bëhesha sikur rrezitesha. Pas pak çohem për t'u larë dhe shoh se pas meje vjen një nga djemtë që flisnin pak më parë. Pas një noti të mirë bie mbi zall që të rrezitëm. Edhe ai ishte shtrirë afër meje dhe më shikonte... Dikur u afrua edhe më afër dhe më tha:

"Hyrë edhe një herë në ujë se dua të të them diçka".

E, unë nuk i thashë gjë, por vetëm qesha me ironi. Ai u ngrit, hyri në ujë dhe priste që të shkoja edhe unë pas tij...

Por, kur pa se unë nuk shkoja, doli nga uji dhe erdhi përsëri afër meje dhe u shtri mbi rërë...

E solla në mendje: të çuditshëm janë djemtë: të ngacmojnë edhe pa të njohur, edhe pa ditur a ke ti të dashur a jo...

Edhe të nesërmen veproji njëjtë, si një ditë më parë. Madje, këtë ditë edhe më pyeti si quhesha. Dhe, nuk di as vetë nga e kishte mësuar, por më tha se ma di emrin... Mbete e habitur kur tha emrin tim...

Pas dite më erdhi edhe një sms dhe një foto imja, duke u rrezitur në plazh... Oh, s'e keni idenë si më lëvizën "fluturat" në bark... E lexova dhe nuk i ktheva përgjigje.

TI DO BËHESH E IMJA...

Pas nja dy orësh më erdhi një sms tjetër, ku më thoshte: "Ti do bëhesh e imja".

Dhe, ndodhi si ndodhi, unë me familjen time përfundua pushimin në Ksamil. Kur u ktheva në Zvicër, disi edhe marrëdhënia ime me ishin u ftohë aq sa edhe u ndamë. Pas disa ditësh i shkruaj atij të Ksamilit një sms:

"Të lutem, prej nga je?"

"Jam nga Prishtina", ma ktheu ai.

Dhe, që të bindem se ai, vërtet, ishte nga Prishtina, e që mua më shkonte shumë për shtati, e lus të më thërriste në telefon nga një numër fiks. Nuk kaluan as pesë minuta dhe nga një numër fiks nga Prishtina dëgjova zërin e tij. Ishte po i njëjti zë që e kisha dëgjuar edhe në plazh, në kohën kur më pyeste si e kam emrin dhe që të hynim në ujë bashkë...

Tash s'ka ditë që nuk komunikojmë me telefon. Në korrik do të takohemi përsëri në të njëjtin plazh, në Ksamil.

Dhe, gjithë ata që dëshirojnë të na njohin do na shohin të përqafuar më 10 korrik, në plazhin e Ksamilit, afër restorantit "Abiori bar".

Vitore H.

Modele: Nora Istrefi

BOOM

Do të habiteni
se çfarë shkollash
e fakultetesh
kanë kryer
këngëtares tona

Me kë e bëri
djalin Çiljeta?

Fjolla Morina
dy vajza
me dy burra
që nuk njihen

Me kë e ka vajzën
Dafina Dauti?

Nora e bënë hitin,
por a ka gjetur të dashur?

Do të habiteni se çfarë shkollash e fakultetesh kanë kryer këngëtaret tona

Janë të shumë artistët e skenës shqiptare që kanë vendosur të studiojnë për diçka krejt tjetër nga ajo që bëjnë realisht. Motivet e këtyre përzgjedhjeve kanë qenë të ndryshme. E pavarësisht se janë diplomuar, pak prej tyre i ushtrojnë profesionet e tyre të vërteta. Por cilat janë degët në të cilat janë diplomuar yjet? Disa prej tyre do t'ju surprizojnë.



REZARTA SHKURTA

Rezarta Shkurta ka mbaruar Akademinë e Arteve në degën e pikturës, por nuk e ushtron si profesion. Përveç pasionit për muzikën, vajza durrsake menaxhon prej kohësh biznesin e saj privat.

GILI

Këngëtarja e njohur kosovare, që nisi të merrej me muzikë që në adoleshemce, ka studuar për gjuhë dhe letërsi shqipe në fakultetin e letërisë në Prishtinë. Ajo, ka punuar për një kohë të shkurtër si arsimtare e gjuhës shqipe, punë të cilën e la për shkak të angazhimeve në muzikë.



SAMANTA KARAVELLA

Samanta Karavella ka studiuar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja Tiranë, në degën gjuhë spanjolle.



SONI MALAJ

Soni Malaj po ashtu është një ish-studente e të njëjtit fakultet ku ka studiuar Samanta. Ajo është diplomuar në gjuhë frënge.



ZANFINA ISMAILI

Ndoshta nuk e dinit, por këngëtarja atraktive nga Prishtina ka studiuar në UP në fakultetin Juridik. Zanfina aktualisht punon në një zyrë si juriste, për çka edhe e ka lënë muzikën pas dore.

ENEDA TARIFA

Eneida Tarifa di të ndezë skenën e clubeve më në zë të kryeqytetit, por vajza çapkëne e ekranit ka edhe një diplomë në degën Punë Sociale.



XENSILA MYRTEZAJ

Xhensila Myrtezaj ka marrë që në vogëli leksione kantoje, është profilizuar në Liceun Artistik të Tiranës, por kur bëhej fjalë për studimet e larta bukuroshja zgjodhi të studione "Marrëdhënie me publikun".



ELVANA GJATA

Kameleoni Elvana Gjata është diplomuar në Universitetin e Tiranës për regjisorë, një degë që aktualisht nuk e ushtron, por me gjasë shfrytëzon dijet e marra në klipet e saj.

N.Neziri

Edhe skena jonë muzikore njehë këngëtare që janë nëna beqare, të cilat i rrisin vetë dhe me mjaftë përkushtim fëmijët e tyre. Këto gra nuk kanë pranuar asnjëherë ti prezantojnë në publik burrat me të cilët i kanë sjell fëmijët në jetë.



ME KË E BËRI DJALIN ÇILJETA?

Rast më i veçantë është ai i këngëtares nga Shqipëria Çiljeta Xhilaga, e cila asnjëherë nuk e ka treguar imazhin e personit me të cilin ajo e ka sjell të birin në jetë. Fansat e këngëtares gjithmonë kanë qenë të interesuar të dinë më tepër për këtë pjesë dhe krejt çfarë kanë kuptuar është se ish partneri i Çiljetës nuk është shqiptar.

Këngëtares tona që kanë fëmijë, por nuk dihet me kë



FJOLLA MORINA DY VAJZA ME DY BURRA QË NUK NJIHEN

Po ashtu edhe këngëtarja kosovare e cila është bërë nënë për të dytën herë, mban të fshehtë babain e vajzës së parë dhe të dytë. Fjolla Morina ka folur pak për babain e vajzës së dytë, por vajza saj e madhe Lediana, vazhdon të jetojë me familjen e ish-bashkëshortit të saj, ani pse këngëtarja ruan marrëdhënie të mirë me të bijën.



ME KË E KA VAJZËN DAFINA DAUTI?

Një nënë beqare konsiderohet të jetë edhe këngëtarja Dafina Dauti. Këngëtarja simpatike, ndonëse beqare, është nënë e një vajze, ndërsa nuk ka prezantuar kurrë babain e vajzës.

N.

Nora

e bënë hitin,
por a ka gjetur
të dashur?

Promotore e fuqishme e një frymë avangarde të të veshurit, e stilit të veçantë dhe unik. Nora Istrefi, kurrë nuk ka qenë “këngëtare kukull”, nga ato që në skenë bëjnë poza e jo muzikë. Nora, është rikthyer e fuqishme me projektin e fundit në bashkëpunim me Besnik Çakën, në këngën me titull “Ki me lyp me m’pa”. Kjo këngë është hiti i padiskutueshëm i momentit dhe Nora po duket thjeshtë perfekt. Sa i përket zhvillimeve në jetën private, Nora nuk e thotë asnjë fjalë.



Pse fëmija im i ngjanë shumë fqinjit tim?

*Më habit fakti pse
fëmija im nuk i ka
sytë e zezë si unë, por
i ka të kaltër si fqinji
ynë!*

Ishte ulur burri pas shporetit dhe
pinte duhan. I bërtiste gruaja se nuk
po ngopej kurrë me atë drej duhan.
Dhe, teksa gruaja e qortonte, i thotë:
"Fëmija sa shumë i ngjanë babait të
vet... Sykaltër si deti..."

"Nga e di ti si është deti, moj?! Kur
ishe ti atje?!", ia kthen ai.

Gruaja vazhdon të lozë me fëmijën
dhe i thotë: "Shihja sytë sa të bukur, i
ka të kaltër si qielli!"

"Nuk i kam sytë e kaltër moj?", ia
kthen burri.

"Nuk po them për ty ore, por për
babanë e tij!", thotë ajo.

Heu, them me vete: Ku të dish se çfarë
kumbarie qenka luajtur te gruaja?!
S'besoj se ka mundësi të ndodhë
kloni rastësor...

Megjithatë, më bie në mend se nipi
që është në Zvicër, një ditë, më tha:
"Dajë, mua nuk më merr shumë malli
për ty!"

Më befasuan këto fjalë dhe i thashë:
"Nip, tash kanë dal mjetet komunikimi
dhe po shihemi shpesh, prandaj edhe
nuk të merr malli..."

E, ai ma ktheu:

"Jo, dajë, nuk po e di ku po dal. E kam
në Zvicër një njeri në punë që të ng-
janë ty tërësisht! I tëri është si ti: me
fyturë, me duar, me sy, me flokë, me
të gjitha... Pyete nënën dhe të tregon
edhe ajo..."

"Mirë, ka gjithkund nga një model",
them unë. Ndërkohë, më bie në mend
se as babai e as nëna kurrë nuk kanë



qenë në Zvicër... Por, ka mundësi të ketë qenë babai i tij këndej pari... Ndodh gjithçka... Kurrë mos thuaj kurrë!”, i them vetes dhe habitem edhe vetë se sa thellë i hyra kësaj pune.

BASH KUR MENDON SE GRUAJA TË DO, TA BËN VARRIN PAS SHPINE!

E, Zoti është çdo kund rreth nesh për të parë se çfarë ndodh në tokë, te njerëzit. Si produkt i kësaj fjale të urtë popullore, Zoti i ekuilibroi botët gjinore. Burrit i dha fuqinë prej burri, gruas heshtjen. Pse?

Sepse asaj, bashkë me heshtjen, i dha edhe dinakërinë. Dhe, tek tash më kujtohet pse zonjat e bartin bishtin e dhelprës rreth qafës... Pra, dinakërinë. Gruaja duket gjithnjë se nuk e kupton burrin, por, në fakt, ajo elaboron edhe përtej asaj që duhet, madje duke hyrë edhe në botën e paragjykimit. E, çka i duhet gruas dinakëria? Burri ekspozon fuqinë duke treguar muskujt e vet para gruas. Ajo, në raste të tilla, heshtë dhe me një buzëqeshje të vogël e tërheqë atë duke i thënë “të dua”. Dhe, kur burri është i bindur se gruan e ka për vete plotësisht, ajo mund të jetë në valët e detit e shtrirë në shpinë. A po e dini për çka e kam fjalën? Për dallgët që e luhatin kah të donë ato vetë...

A GËNJEJNË SYTË?

Një burrë e kishte zënë gruan në flagrancë amoraliteti dhe i kishte thënë të zura. Gruaja ish ankuar se kurrë s’e kishte tradhtuar. E, gruaja për ta bindur burrin se sytë gënjejnë, e kishte çuar te muratori. “Punë të mbarë, murator! Çka po bën, o mjeshtër?”, i kishte thënë gruaja. “Po ndërtoj mur”, i ishte përgjigjur ai. “Pse e ke zgjatur atë pe?”, ia kthen ajo. “Që muri të bëhet drejt”, i thotë muratori. “A pa pe nuk shkon muri drejt, a?”.

“Jo, zonjë, syri të mashtron!”.

Prandaj, edhe në këtë rast gruaja del fituese ndaj burrit se atë e ka mashtruar syri...

PSE GRUAJA E MBAN MBI QAFË BISHTIN E DHELPRËS?

Një rast tjetër, një grua i nënshtrohej zullumit të burrit. Pasi burri e rrahë, i thotë të vijë në arë e të hedhë kokrra misri.

Gruaja mori një enë mbushur me peshq të vegjël dhe në vend të kokrrave të misrit pas burrit hidhte peshq. Dhe, kur burri me pllug i mbulonte kokrrat e misrit, pa se mbulonte peshq. Ai, në çast, u ndal dhe mendoi se Zoti nga qielli i lëshonte peshqit.

I tha gruas t’i mblidhte peshqit dhe t’i fërgonte për drekë...

I mbledhë gruaja peshqit dhe shkon në shtëpi. Por, nuk i përgatit për gatim. Kur erdhi burri në shtëpi, me shpresë se do kishte peshq në sofër, gruaja i solli specia turrshi.

“Ku janë peshqit?”, i thotë ai.

“Cilët peshq?”.

“Ata që i mblodhe në arë!”.

“Ti je çmendur! Ku ka peshq në arë?!”.

Burri u ngrit nga sofra dhe e rrahu gruan si edhe herë të tjera...

E, ajo nga zemërimi i thirr vëllezërit dhe u thotë:

“Është çmendur! Do më mbytë!”.

“Pse e rrahë gruan?!” i thonë ata.

“Gjetëm peshq në arë dhe i thashë t’i bëjë për drekë, por nuk i ka fërguar!”, u thotë ai.

Ata u shikuan në sy me njëri-tjetrin dhe, të bindur se ishte çmendur, e rrahën me rend derisa ai mbet i shtrirë në tokë...

Por, kjo gruas nuk i mjaftoi. Dëshironte ta rrihnin edhe më shumë... Dhe, për të arritur këtë, nxjerr nga pala e dimive një peshk dhe ia tregon shoqit. Kur ai e sheh peshkun thotë:

“Që peshku! U kam thënë unë!”.

Ata i hyjnë prapë dru derisa u lodhën... Prandaj, besoj se mjaftojnë këta shembuj që i thashë që ta kup-toni pse gruaja e bartë rreth qafe bishtin e dhelprës...

S. Murturi



Tanku serb në Prelez


Prelezi, fshat i komunës së Ferizajt, ka një shtrirje të madhe pranë rrugës Ferizaj-Prishtinë dhe me disa lagje.

Por, ajo që e veçon këtë fshat, veç të tjerash, është edhe një tank serb, i cili dëshmon se në këtë vend ka pasur mjete të rënda luftarake gjatë kohës së luftës më 1999.

Tanku i okupatorit serb në këtë fshat ruhet si dëshmi e dëbimit të shqiptarëve. Tanku qëndron në po të njëjtin vend qëkur u bombardua nga forcat e NATO-s. Banorët e këtij fshati shumë herë në mjetet e informimit kanë treguar për rastin e bombardimit nga NATO mbi forcat serbe.

Sipas tyre, vizitorë të shumtë vijnë ta vizitojnë këtë vend, duke u njohur më për së afërmi me historinë e këtij tanku, e që shihet edhe në fotografi. Objekte të tilla si ky tank, banorët i quajnë me vlera të mëdha, sepse në këtë mënyrë nuk harrohet historia e këtij vendi dhe e gjithë Kosovës.

Shyqyr, e kam burrin të shkolluar, jo politikan!



Shumë nga gratë e rëndomta ua kanë zili atyre grave që i kanë burrat të famshëm, politikanë. Do të jepnin gjithçka që edhe burri i tyre të ishte i njohur. Por, ka edhe të tilla që nuk duan që burri i tyre të jetë i njohur, por duan të jetë i shkolluar, i thjeshtë, punëtor, pa probleme...

V. T., 41 VJEÇE, NGA PRISHTINA, GRUA E PROFESORIT:

- Jam e martuar dhe i kam dy fëmijë. Im burrë është profesor. Kurrë nuk do e mer rja burrë politikanin. Sepse, po e shihni edhe vetë se si po zhyten në korrupsion, në dallavere me tenderë të ndryshëm, të përfshirë në afera korruptive, siç po flitet tash për ambasadorin e Kosovës në Slloveni!

Thjesht, më pengon fama e burrit, sepse ai, pastaj, do e ndjej veten lart e unë do mbetëm nën hijen e tij...

Shkurt e shqip: Nuk dua që burri im të jetë në qendër të vëmendjes, por unë. Sepse, po të jetë ai në qendër të vëmendjes, pa dyshim, nuk do të ketë kohë t'më përkushtohet mua, por ndonjë tjetër, me të cilën edhe e lidhë vendi i punës, udhëtimi zyrtar, shoqëria...

Andaj, shyqyr Zotit, burrin e kam profesor: shkon në mësim, kthehet pas mësimit te unë në banesë dhe bashkë me fëmijë pasdite dalim në ndonjë vend për të pirë kafe apo edhe në shëtitje.

S. B., 39 VJEÇE, NGA PEJA, GRUA E INXHINIERIT:

- Do të doja ta kisha burrin të famshëm, bie fjala, të jetë futbollist apo i ndonjë sporti tjetër, por kurrësi edhe politikan, këngëtar apo artist. Bie fjala, po të jetë im

burrë artist, ai do luajë edhe role të ndryshme dashurie. Pra, do të jetë në përqafim të tjetrës. E, unë të shkoj në teatër e ta shikoj se si puthet ai me tjetrën, a?! Jo, sepse jam xhelozë dhe nuk do toleroja gjëra të tilla kurrë.

Im burrë është inxhinier, ka firmë të veten dhe punon pa ndalur, kështu që edhe punët i kemi mirë. Unë i jam përkushtuar me mish e shpirt vajzës sonë, ajo tash është 5 vjeçe: e dërgoj në çerdhe dhe vetë kthehem në shtëpi e i kryej punët e shtëpisë. Kah ora 14 shkoj në ndonjërin nga kafiteritë që ndodhen afër çerddes së vajzës, takoj ndonjë shoqe, por ka raste edhe ndonjë shok nga shkolla e mesme, dhe pi kafe nja një orë a një orë e gjysmë, deri kur edhe vjen koha që ta marr vajzën nga çerdhja.

Në mbrëmje mua dhe vajzën burri shpesh herë na dërgon në ndonjë restorant për të ngrënë darkë.

L. E., 43 VJEÇE, NGA FERIZAJ, GRUA E PUNËTORIT TË ADMINISTRATËS:

- Thënë të drejtën, ndoshta pse jam e lindur e rritur në fshat, e që nuk ishim mirë materialisht, nganjëherë më shkon mendja te to dhe them lum ato që i kanë burrat politikanë: kushte të mira po, shëtitje po, verës në det po, vetura luksoze po, sepse veturë të keqe sot ka pothuajse

çdo shtëpi, ahengje e sorollatje poshtë e lart po.

E, çka i duhet njeriut tjetër?

Por, ka edhe raste që kur po i dëgjoj në televizor se si po i shajnë disa nga politikanët tanë që po vjedhin sa po mundin dhe them me vete: Shyqyr Zotit që im burrë është punëtor administrate dhe nuk ka çka me vjedhë se ndoshta do të bëhej si ata që i përmenda pak më lart.

Sidoqoftë, kur kthehet burri nga puna, unë dhe fëmijët (një vajzë e një djalë e kemi), ulemi bashkë dhe hamë drekë, pastaj ai shikon televizor, kurse unë i laj enët apo ndonjë gjë tjetër. Në mbrëmje, thënë të drejtën, kënaqem duke i shikuar serialet turke dhe jam mishëruar me to.

E, për dalje në dreka e darka, siç bëjnë gratë e politikanëve tanë, unë nuk i kam kushtet, por nuk prish punë, edhe pse nuk dal. Shpesh me fëmijë shkoj në familjen time dhe rri nga dy-tri ditë, e fëmijët kënaqen në ajër të pastër, sepse majën e Lybetenit e kemi shumë afër.

SI TA PËRMBYLLË KËTË SHKRIM?

Jetë të mirë bëjnë gratë e politikanëve, por edhe problemet i kanë të mëdha: Ku shkoj burri? Pse nuk erdhi burri? Sa do të rrijë këtë herë në udhëtim zyrtar burri? A do e qesin edhe tim burrë në televizor për hajni, siç po i publikojnë të tjerët? E, të tjera të ngjashme...

Diturie Haxhaj



Cilës këngëtare i ngjanë gruaja ime?

Nuk e dija se pamja e saj i ngjante shumë figurës së gruas sime. U desh disa ditë të zbuloja se gruaja ime kishte një klon, të cilën mund ta dërgonte në punë, mund ta dërgonte në shërbim, mund ta dërgonte edhe jashtë shtetit. Thjesht, kudo që donte vetë mund ta qonte me bindjen se ishte ajo vetë. Pas disa ditësh mu kujtua se ajo fytyrë e këngëtares që më rrinte para syve i ngjante gruas dhe bërtita nga gëzimi se, më në fund, e qëllova, se truri ende nuk më ishte shlyer. Por, truri im i mbanë mend vetëm pamjet që i do shpirti...



Qëndrova disa orë në kafenenë ku u këndua pastër shqip, e jo tallave. Aty ndodhej edhe ajo. Më ngjante në dikë, por nuk mund ta kujtoja modelin e fytyrës që i

ngjante. Më mbetën në kokë tiparet e saj, por memoria nuk ma shpaloste figurën tjetër të këtij kloni rastësor. Ishte fytyrë që më ngjante në dikë,

por nuk mund ta qëlloja. Isha pre-okupuar aq shumë me këtë fytyrë, por nuk më vjen në mend zgjidhja. E njëjta fytyrë më sillej në mend si ajo që e njihja. E njëjta gjatësi trupi si ajo. E njëjta frizurë dhe me pamje të njëjtë floku, të njëjtat buzë dhe e njëjta fytyrë rrumbulake.

Sillem e pështillem, mundohem ta gjej modelin sa të them me zë të lartë "eureka" nga gëzimi, por kot. Edhe pse mundohem ta gjej klonin e asaj fytyre, disi sikur më është zbehur memoria.

Kam njohur shumë fytyra, por fytyrat kanë ndryshuar e nuk janë më ato që ishin dikur. Ndoshta edhe unë kam të drejtë? Ka të drejtë ndoshta edhe memoria ime që është mërzhitur duke mbajtur në klik çdo lloj fytyre dhe më nuk do të lodhet me këso fytyra të padefinuara.

E di se është një klon rastësie, por nuk më bie në mend se me kë ngjanë, cila fytyrë i ngjanë asaj fytyre. Jam kureshtar ta gjej, lutem t'më shkrep një rrufe në mendje, por sërish kot...

KËNGËTARJA NGJANTE NË GRUAN TIME

Në një moment vjen ajo në tavolinën time dhe më përshëndet butë. Ashtu si edhe këndon butë. Pastaj, më lë një numër telefoni. Dhe, tërë storien e shikon një tjetër femër nga tavolina e fytyrës së klonuar dhe ma bën me gisht në shenjë qortimi për numrin.

Fill e ftoj në tavolinë gjithë gaz. I them të mos xhelozojë, sepse për ty mendoj seriozisht, kurse atë e kam vetëm për puthje!

Ha-ha-ha nis gazi dhe zgjat bukur gjatë. Në një moment nxjerr telefonin për të kërkuar një foto dhe më dalin para syve fotot për Vitin e Ri 2020, kur kemi dal me gruan në shtëpi dhe shoh se fytyra që i ngjanë asaj fytyre në kafene

është fytyra e gruas sime...

Po, si nuk më është kujtuar deri tash?!

Si është e mundur të jetoj me atë model fytyre e të mos më kujtohet se është modeli i gruas sime?! E gjeta. Kjo zonjë qenka modeli i gruas sime... Po sikur ta marr në shtëpi për kafe do ta befasoja gruan! Mirë është të dy të pimë kafe me gruan. Do të ishte shumë e dobishme. Nëse ndonjë ditë nuk do të mund të shkonte gruaja ime në punë, lirisht do të mund ta qonte modelin e vet në zyrë.

Por, jo, nuk qenka bash ashtu, meqë gruaja nuk di të këndojë... Sidoqoftë, e gjeta modelin. U bë shumë mirë që e gjeta dhe e pushova mendjen. Nuk më binte në mend se po jetoj me një model të tillë fytyre në shtëpi...

A jam plakur, a thua, që jam bërë kaq budalla?! Shikohem në pasqyrë, ashtu sikur më thotë gruaja sa herë që i duket se për ndo gjë s'e kam mirë.

"Shikohu në pasqyrë, njeri!", më thotë.

Shikohem, por nuk shoh se jam plakur. Mirë jam shumë, i kam të gjitha që i kisha dikur, edhe si i ri, edhe kur u bëra pak më shumë se i ri...

Nuk po më duket asgjë keq, por njeriu në fytyrën e vet nuk i sheh brirët...

Por, rëndësi ka se pas dy netësh ndeje në kafene e zbulova se modeli i asaj femre që rrinte aty i ngjante shumë gruas sime...

Nuk jam i pa mençur, a? Mund të lavdërohem si ai burri që ishte nisur nga Kaçaniku për në Prishtinë. Qysh në Kaçanik e kishte marr shkrepën të ndezte cigaren dhe me të hyrë në "Veternik" të Prishtinës shkrepse i ndezë dhe në atë moment thotë: "Luaje shkrepse ime, luaje... nga Kaçaniku te "Veterniku"!

SOT GRATË BËJNË QEJF SI DUAN VETË...

Dhe, teksa i mendoj këto gjëra, vjen fqinji im nga Gjermania. Nuk jemi takuar që shumë vjet. Na i bën gruaja kafetë e bashkë me kafe edhe nga një gotë verë. E, teksa pimë, hapet muhabeti i para shumë viteve para lufte...

Ka qenë më mirë atëherë apo jo? Për mua dhe fqinjin e mërzhitur në kurbet ka qenë më mirë dikur, por për gratë më mirë është tani. E gratë, me siguri, e kanë mirë. Dikur nuk ka ekzistuar shoqëria familjare apo ka qenë shumë e rrallë, thotë fqinji dhe unë pajtohem që e ka mirë. Por, gruaja nuk pajtohet. "Nuk po e qëlloni asnjëri", thotë ajo dhe vazhdon: "Dikur ka pasur shoqëri e muhabet shumë më shumë se tash. Kanë ekzistuar kumbaritë dhe ndrikullat me të cilët është bërë një muhabet i hapur dhe mjaft shliur. Kumbara ka pasur të drejtë të hyjë në shtëpi edhe nëse nuk ka qenë aty i zoti i shtëpisë. Edhe ndrikulla ka pasur të drejtë të shkojë në shtëpi të kumbarës edhe nëse nuk ka qenë e zonja e shtëpisë aty".

Sa mirë i definon gruaja gjërat...

Dhe, mendja më shkon te modeli i fytyrave. "A mos ka pasur babai i gruas ndonjë kumbar në Shqipëri?", pyes veten. Paskësh mundësi, pra, i them vetes. Nuk qenka krejt rastësi, me siguri. A mund të jenë motra, ore?!

Ndërkohë, fqinji sheh se jam tretur në mendime, si në mjegull dhe më thotë se qenkam bërë unë mu si ai në kurbet.

"Jo-jo, nuk jam humbur, por vërtet isha kah mendoja për kumbaritë që ka pasur ky vend dhe shumë me vend e ka gruaja. Bile, paskam mundësi të kem fakte", i them atij, sa për ta përmbyllur bisedën, e që më dukej se nuk kishte fund...

S. M.

Rrëfim i vajzës
që e braktisi i dashuri...

Pse Zarifja 20 vjeçe u detyrua të abortojë?

Pak muaj para se të fillonin përgatitjet për dasmë, ai e shtyri të abortojë! E mbësheti për muri dhe ajo nuk dinte kah t'ia mbante. Edhe po të vdiste gjatë abortimit ishte njësoj për të, vetëm se nuk donte t'i dilte familjes përpara me bark të fryrë, sepse do i lëndonte pa masë. Këto janë fjalë të Zarifës, 20 vjeçe, e cila mendohej të gjente një gjinekolog që të abortonte, sepse i dashuri i saj nuk i kishte treguar se ishte i martuar dhe kishte grua e fëmijë...

Një çift i ri dashnorësh, ulur në ulësen e drunjtë të parkut në ambientet e Klinikës së Gjinekologjisë në Prishtinë, kishin një hall tepër të madh, të cilin as që dëshironin ta bënin publik, sidomos kur mësuan se unë jam gazetare. Ishin të trembur nga ajo që u kishte ndodhur. Po bënin ç'është e mundur që të bënin një zgjidhje "fatlume" për katandisjen e tyre shpirtërore, por ende nuk kishin arritur t'i vënin kapak punës së tyre...

"Nuk dua të marthohem dhe të krijoj familje me të!", theksoi Zarifja, 20 vjeçe, nga Deçani, sy për lotur.

MU KA DJEG ZEMRA, TASH E KAM RRAFSH!

"Nuk e kam ditur se ishte i martuar! Kam shpresuar se do të bëhem nuse e tij. Por, ja se ç'ndodhi... Kemi ardhur në pikën kulminante që të abortoj, edhe pse nuk më ka shkuar kurrë në mendje se mua mund t'më ndodh një gjë e tillë", thotë Zarifja.

Për të më e keqja ishte se një mjek i kishte thënë se nuk i lejohej aborti, sepse, sipas tij, ishte në kundërshtim

me rregullat e klinikës. Ajo dridhej, derisa qëndronte as në tokë e as në qiell, duke pritur "një fund të saj të lumtur".

"Mu ka djeg zemra dhe tash është njësoj për mua, edhe nëse vdes gjatë abortimit s'prish punë vetëm se nuk dua, në asnjë mënyrë, të dal me bark të fryrë para familjes sime, sepse do i turpëroj.

Por, edhe nëse nuk do mund të abortoj nuk do bëhem nuse e tij, sepse unë nuk dua të jem grua e dorës së dytë të askujt", thotë me mllef Zarifja. Dhe, pas nja gjysmë ore largohem nga Zarifja, duke mos i dhënë kurrfarë këshille, sepse në raste të tilla është vështirë ta këshillosh dikë se si të veprojnë... Ndoshta në ndonjë klinikë private do të kishte mundur të bënte zgjidhje, por nuk i thashë gjë, sepse nuk doja të hyja në gjynah. Përndryshe, është e detyruar që kur të vijë koha edhe të lindë foshnjën, dashur e pa dashur...

Keq për rastet e tilla, e që, me siguri, rasti i Zarifës nuk është i vetmi...

D. Haxhaj



'Turquoise Marina', shtëpia juaj pranë varkës, biçikletës dhe plazhit

Turquoise Marina pozicionohet në Hamallaj, në veri të qytetit të Durrësit me një distancë prej afërsisht 20 km, në Jug me Rezervat Natyror, në Lindje nëpërmjet kanalit të Hidrovorit, ndërsa në Perëndim me detin Adriatik.

Turquoise Marina është ndër projektet më të mëdha, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajonin e Ballkanit, me një sipërfaqe totale prej 350'000m2 (35 ha).

Rezidenca e Risive, sjell për herë të parë në Shqipëri Marinën Rezidenciale me mbi 200 vendparkime të mjeteve lundruese; pistën më të gjatë të biçikletave në zonë prej 3'000 ml korsi biçikletash; një galeri rëre e cila do të jetë katalizatori kryesor i aktiviteteve rekreative për të gjitha moshat dhe AQUAPARK-un e zhvilluar brenda një hapësire banimi.

Projektuar për të qënë e qetë dhe komode për individët dhe familarët që dëshirojnë të shijojnë natyrën, aty ku ofrohet siguri, cilësi e lartë ndërtimi dhe infrastrukturë. Të gjitha vilat dhe apartamentet kanë akses të drejtpërdrejtë me detin Adriatik.

Investimi ka në përbërje hapësira të dedikuara për pishina, Aquapark, Marine Port, bare, restorante, hapësira shërbimi në funksion të komunitetit.

Në mënyrë shumë të kujdesshme është planifikuar sistemi rrugor dhe sistemi i parkimeve, duke e bërë më të sigurt jetën e këmbësorëve, dashamirësve të biçikletave dhe duke rregulluar qarkullimin e makinave.

Plani ynë i zhvillimit, në Marinën rezidenciale, ofron menaxhim eficient në shërbimet bazë si, siguria, mirëmbajtja, administrimi i rezidencës dhe gjelbërimi e pastrimi i hapësirave të përbashkëta.

- Siguria përfshin sallat e monitorimit, sistemet e alarmit, CCTV 24/7, kontrollimin e aksesit të hyrjeve në Rezidencë. Staf i kualifikuar me një bashkëpunim rigoroz me kompaninë më të suksesshme në treg.
- Mirëmbajtja përfshin kujdesin për ujin e pijshëm, rrymën elektrike, sistemet e kanalizimit të ujrave të bardha e të zeza, mirëmbajtjen teknike dhe elektrike.
- Administrimi i rezidencës nga kompania S&D Invest, duke përfituar kështu nga eksperiencia 14 vjeçare e menaxhimit dhe bashkëpronësisë.
- Gjelbërimi dhe pastrimi i hapësirave të përbashkëta por edhe atyre individuale.

Turquoise Marina është investim i kompanisë së ndërtimit dhe zhvillimit të rezidencave në Shqipëri, AGIKONS Sh.P.K, që operon prej vitesh në tregun vendas dhe

atë ndërkombëtar, në fushën e menaxhimit të pronave dhe menaxhimit turistik.



HAMALLAJ, GJIRI I LALËZIT

Të jetosh nën gjelbërimin e përhershëm dhe pranë bregdetit shqiptar është parajsja që keni kërkuar. Bregdeti shqiptar i Adriatikut ka klimë mesdhetare me ndikime të konsiderueshme detare dhe subtropikale. Tokat pyjore mbizotërohen kryesisht nga gjelbërimi i përhershëm.

Ajër i pastruar nga pylli i pishave dhe jodizimi i detit, sjell për ju zgjedhjen ideale për t'iu dhuruar një jetesë të qetë, larg zhurmës slarg zhurmës së përditshme të qyteteve.

Tel: +355 68 409 9082
E-mail: sales@agikons.com

Kurrë nuk qesh dashnori i parë e as i treti, por vetëm i dyti!

Rastësisht u gjenda në Qendrën e Studentëve, teksa kërkoja një të afërm timin, me të cilin kisha të kryeja një punë familjare. Më tha se mund ta takoj në mensë, e prej aty të shkojmë në ndonjë lokal e të bisedonim për problemin që kishim. Por, posa u ulëm në kafenenë përballë konvikteve të studentëve, na u bashkëngjitën edhe dy cimerë të tij dhe biseda mori kah krejt tjetër...

Asnjëri nuk mbante fshehur asgjë. Dëshirat dhe hallet i ndajnë me njëri - tjetrin. Njërit nga ta i pëlqen një femër zeshkane, por nuk mund të dalë shpesh me të, sepse nuk ka para të mjaftueshme. Tjetrit ia kishte marrë mendtë një vajzë në autobus dhe tani kërkonte ndihmën e cimerëve se çka dhe si duhet t'ia bëjë me të... Ndërkaq, Fisniku, i afërmi im, e kishte mendjen vetëm te provimi që do e ketë javën e ardhshme, edhe pse profesoresha qe dy herë e kishte rrëzuar në provim. Dhe, sikur të mos kishin obligime në ligjëratat dhe studime, pash se jeta studentore për ta ishte interesante, e papërsëritshme. Secili nga ta fantazonte në mënyra të ndryshme...

KURRË AS I PARI E AS I TRETI...

Më afër meje ishte i ulur Fisniku, i afërmi im. Dhe, nga pamja se si ishte veshur, nuk të jepte edhe aq pamjen e një studenti, me një unazë ari në gisht.

"Për mua nuk ka krizë as për para e as për femra. Veç zgjate Zot kështu!", thotë ai. "Nuk kam ndonjë hall tjetër veç nervozes që më ka kapluar qe nja një orë: e lamë të takohemi me një femër para Mensës, e ajo s'doli!".

Fisniku është nga Gjilani, kurse familjen e ka në Zvicër dhe të gjithë punojnë. Andaj, krizë materiale për të nuk ka, veç asaj që

femra e dëshiruar nuk i doli në takim.

"Sa për martesë ende nuk po mund të gjej femrën e dëshiruar, femrën ideale. Pse, vëlla, nuk tregojnë drejt sa frajera i kanë pasur, por gjithmonë më thonë se jam i dyti... Pra, kurrë as i pari e as i treti!", shprehet ai.

E GJEN FEMRËN, POR SI ME E MBAJT?

Valoni dhe Nehati, meqë të dy janë nga Vitia, thonë se vetëm të premtëve dhe të shtunave në mbrëmje dalin, sepse edhe vajzat e konvikteve ato ditë dalin më shumë...

Problemi më i madh për ta është se që të dalin me ndonjë femër duhet t'i kursejnë paratë që ua japin në shtëpi.

"50 euro m'i dha babai kur u nisa të dielën për në Prishtinë. Çka të bëj më parë me ato para? Edhe nëse e gjej ndonjë femër nuk kam guxim t'i them të pimë diçka... Sot është lehtë të gjesh femër, por është vështirë ta mbash, sepse jeta dashurore e studentit kushton. Unë student, ajo studente... Të dy pa para. Keq, a?!", shpreh brengën e tij Valoni, 23 vjeç, i cili javën që shkoi e kishte pasur një provim të vështirë në Fakultetin Teknik dhe kishte rënë për së treti herë...

Po të njëjtin hall e ka edhe vendasi i tij, Nehati. "Edhe femrat po ikin prej nesh kur po

shohin se jemi keq materialisht. Thënë të drejtën, po u dhimbsemi... Andaj, që nga dita e nesërme do të dal kafiq më kafiq dhe do të kërkoj punë me orar të shkurtër, sepse ligjëratat dhe provimet nuk do t'i lë anash kurrsesi", thotë i nervozuar me vetveten Nehati.

PËR POLITIKË LE TË FLET KURTI!

Dhe, teksa muhabeti zgjatet për dashuri, sa për t'i nxitur u them se në konvikte a flasin vetëm për provime e dashuri, apo edhe për politikë...

"Nuk dua të flas për politikë, sepse nuk kam kurrfarë dobie prej asaj pune. Për politikë le të flet Kurti. Politikanët e këqyrin punën e vet, e as që u intereson se si i kemi punët ne, studentët..."

Prej asnjë partie s'ka hajr, sepse secili po i punëson të vetët. E, neve s'ka për të na ardhur koha të punësohemi edhe po të diplomojmë me notën 10!", flet me nxitim Valoni.

"Hiq more politikës, nuk ka hajr prej saj, por si me i krye provimet dhe me e gjet një femër që do më bëhet nusja ime e jetës? Ky është synimi im... Kjo është ardhmëria ime... Kjo do i gëzonte familjen time, të afërmit e mi", ndërhyr me një të folur shumë të shpejtë Nehati, sa për ta përmbyllur këtë temë.

D. H.



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimit 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimit gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritet që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksessit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimit tek këto qendra, me rezultate kaq

të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjamit, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimit.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epiderme), duke shpërbë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimit Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjamit.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjamin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullët trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.

Pse Presidenti i Francës është më i ri se gruaja e tij?

Shumë njerëz pranojnë se dashuria shfaqet në shumë mënyra. Pra, pavarësisht kësaj, pse njerëzit i gjykojnë ende çiftet që kanë shumë vite diferencë me njëri-tjetrin?

Aktori Leonardo Di Caprio, siç është përcjellë, ka pasur të dashura vetëm të moshës së re. Dhe, disa e lavdëronin Di Caprio për aftësinë e tij për të tërhequr femra të reja, ndërsa të tjerë e qortonin aktorin pse nuk gjente dikë më afër moshës së tij.

Një prej të dashurve të Di Caprios ishte edhe Camila Morrone, 24 vjeçe. Edhe ndërmjet Demi Mur e Ashton Kutcher, marrëdhëniet me diferencë të madhe moshe kanë krijuar gjithmonë gjuhë të lëkundur.

Dhe, çiftet me diferencë të madhe në moshë shpesh përballen me gjykime. Disa ekspertë besojnë se kjo mund të ndryshojë, të tjerë argumentojnë se të rinjtë mund të bëhen më shumë mosmiratues ndaj dashurisë me diferencë moshe.

Sidoqoftë, ata që i shohin të pakënd-

shme zakonet e takimit të Di Caprios, nuk janë pa arsye. Aversionet ndaj marrëdhënieve të moshave janë shumë të zakonshme dhe si shumica e tabuve, ato rrjedhin nga mijëra vjet evolucion, si dhe nga shenjat më të fundit sociale dhe kulturore.

ÇIFTET ME MOSHË TË NJËJTË E ZGJASIN MARTESËN

Si për burrat ashtu edhe për gratë, fertiliteti fillon të bjerë pas moshës 35 vjeçe. Dhe, megjithëse gratë humbasin aftësinë e tyre për të mbetur shtatzënë shumë më shpejt, ka kuptim që ne kemi evoluar për t'u tërhequr nga njerëzit që janë në moshë të ngjashme.

Megjithatë, çifti me dikë të një moshe të ngjashme, bën që marrëdhënia juaj të zgjasë më shumë, tregojnë hulumtimet.

Ekspertët besojnë se kjo është për shkak se këto çifte priren të kalojnë nëpër sfida dhe faza të jetës në një kohë të ngjashme dhe për këtë arsye mund të vazhdojnë të gjejnë gjuhën e përbashkët.

"Në 10 vitet e para të martesës, njerëzit raportojnë nivele më të larta të kënaqësisë martesore kur partneri i tyre është më i ri se ata", thotë Grace Lordan, profesoreshë e asociuar e shkencës në Londër, e cila aktualisht është duke hulumtuar lumturinë në marrëdhëniet me diferencë të madhe moshe.

"Megjithatë, me kalimin e kohës, kënaqësia martesore e çifteve me diferencë moshe bie më shumë se partnerët e moshës së ngjashme".

E, femrat që zgjedhin të takohen me burra më të rinj, duket se përballen me një masë joproporcionale gjykimi.

"Gratë që lidhen me meshkuj më të rinj shkojnë më së shumti kundër kokës kur bëhet fjalë për narrativën tonë të martesës dhe kështu gjykojnë më shumë".

MAKRON 24 VJET MË I RI SE GRUAJA

Vëmendja mediatike që rrethoi martesën e presidentit francez Emmanuel Macron, me gruan 24 vjet më të vjetër se ai, apo Kim Kardashian, 41-vjeçare, me 28-vjeçarin Pete Davidson, vetëm e thekson këtë.

Dhe, a do të zhduket tabuja e diferencës së moshës?

Sot, ka një pranim në rritje se të gjitha marrëdhëniet duken ndryshe, pavarësisht nëse kjo lidhet me seksualitetin, gjininë apo edhe numrin e njerëzve në të njëjtën marrëdhënie.

Megjithatë, ka pak prova se magjepsja e shoqërisë me diferencat e moshës po pakësohet. Të ashtuquajturat lidhjet e dashurisë së të famshmëve janë ende rregullisht titujt kryesorë dhe të rinjtë duken edhe më gjykues ndaj marrëdhënieve me diferencë moshe, veçanërisht kur një burrë është më i vjetër se një partnere femër.

Pse jam e etshme ta tradhtoj burrin?

Që nga fëmijëria më ka munguar kujdesi dhe dashuria. Babanë e kisha mësues, ndërsa nëna punonte pastruese në shkollë, sepse kishim kushte të vështira jetese dhe duhej të sigurohej ekzistenca. Unë dhe motra më shumë kujdeseshim për shtëpinë sesa nëna, jo se nuk dëshironte të punonte ajo, por lodhej nga orari i gjatë në shkollë.

AS TE BURRI NUK E GJETA MË MIRË...

Kur isha në shkollë të mesme, në një mbrëmje me shoqe, u njoha me burrin tim. Në ditëlindjen time të 17, ma dhuroi puthjen e parë. Kurse, në ditëlindjen time të 18 isha gruaja e tij!

E doja dhe mendoja se do më dhuronte një jetë të lumtur e pa brenga, e që më kishte munguar deri atëherë. Por, pas tre vjet martesë, për çudi, burri nisi të largohej gjithnjë e më shumë nga unë. Nisi të dilte me femra të tjera... Nuk i fshihte dashnoret e tij, madje edhe mburrej me "zotësinë" e tij.

Mund ta merni me mend si e ndjeja veten kur prej askujt s'kisha ndihmë?! Jetoja në pritje se gjërat do të ndryshonin me tim burrë dhe ai do më kthehej vetëm mua... Por, ai vazhdonte me të veten: shkonte herë te njëra e herë te tjetra dhe për mua as që e kishte gajle...

Isha përmalluar për fjalë të mira të burrit, për ngrohësi e dashuri... E, këto i gjeja te shoku më i afërt i burrit tim...

Unë bëra hapin e parë: i shkrova letër dhe i kërkova të ma dërgonte një panoramë me një trëndafil të kuq, nëse dëshironte

të kishte lidhje me mua. Nuk prita shumë e ai u bë imi dhe i tillë mbeti 20 vjet. Ishte vështirë për të gjetur vend për t'u takuar, meqë na njihnin. Por, unë ia dilja disi...

As burri im e as fëmijët nuk dyshonin në mua sa herë që dilja vetëm nga shtëpia dhe humbja me orë të tëra...

Dhe, vitet kalonin e dashuria jonë ishte e pandryshuar. Mund të shkuroreshoheja nga burri e të martoheja me të, sepse ai ishte pa grua, meqë i kishte vdekur vite më parë, por më dhimbsheshin fëmija, meqë në atë kohë i kisha dy fëmijë.

SI E KËSHILLOVA DASHNORIN TË MARTOHEJ?

Dashnorin e këshillova të martohej, sepse ishte i ri dhe kishte nevojë të krijojë familje, sepse gruaja që i vdiq vite më parë nuk ia lë fëmijë.

Ditën e dasmës së tij nuk m'u drodh zemra fare, sepse isha e sigurt se nuk do e humbisja edhe pse martohej, meqë ai marrëzisht më donte, më dashuronte. Ishte vetëm imi me shpirt e trup...

Në anën tjetër, ishim fqinj dhe shkuarje-

ardhjet te njëri – tjetri nuk mungonin dot. Gruaja e tij as që e dinte se ç'më kishte ai mua...

Por, koha ngadalë tinëzisht e ndryshoi dashurinë time. Dashnori im ishte lodhur nga jeta e dyfishtë dhe iu dha pijes. Atë ditë kur u zbulua dashuria jonë ai kishte pirë shumë. Ai nuk ishte përmbytur dhe vjen te unë, në shtëpinë time. Në derë e pret burri im me revole në dorë. Nuk frikeshesha për vete, por më dhimbsej dashuria e tij e madhe që kishte për mua. Ia nxora shpejt e shpejt nga dora burrit tim revolen dhe ia hodha disa hapa larg. Fatmirësisht, revolja kishte qenë e zbraztë. Erdhi gruaja e vet dhe e mori.

Ai shkoi në shtëpinë e vet, kurse unë mbeta e vetme, nga shikimi i egër i burrit tim.

Në fund, nuk durova dhe i tregova se 20 vjet e kisha tradhtuar. Për çudi, ai u tërhoq dhe nuk nxori zë nga goja...

Pse e bëri një gjë të tillë, as atëherë e as sot nuk e di?

Sidoqoftë, kurrë nuk e kam ndjerë veten fajtores, sepse po t'më donte ai siç e doja unë në fillim, kurrë nuk do ta tradhetoja...

Y. Zh.

Horoskopi i dashurisë *sipas muajit kur ke lindur*



Çfarë tregon muaji i lindjes për jetën tuaj seksuale?

TË LINDUR NË JANAR

- * Këmbëngulës kur u intereson.
- * Të çuditshëm.

... NË SHKURT

- * Aventurier.
- * Të distancuar emocionalisht.

... NË MARS

- * Bëjnë seks mirë vetëm nëse janë të lidhur shpirtërisht me partnerin.
- * Dinë ta çojnë marrëdhënien në shtrat në një tjetër nivel intimiteti.

... NË PRILL

- * Të pandalshëm kur u intereson.
- * "Digjen" në shtrat. Por, kur ka mbaruar, ka mbaruar!

... NË MAJ

- * Duan që seksi të jetë i rehatshëm.
- * Duan të bëjnë seks në jastëkë mëndafshi ose nuk bëjnë fare!

... NË QERSHOR

- * Provojnë pozicione të reja.
- * Adhurojnë seksin në telefon.

... NË KORRIK

- * Besnikë.
- * Duan të japin kënaqësi.

... NË GUSHT

- * Ose ekstremisht egoistë ose ekstremisht bujarë.
- * E urrejnë kur u thua çfarë duhet të bëjnë në shtrat.

... NË SHTATOR

- * Pasionantë, që janë gati të provojnë gjithçka.
- * Duan të ndihen të lidhur emocionalisht me partnerin.

... NË TETOR

- * Nuk nxitojnë.
- * Janë të mirë në joshje.

... NË NËNTOR

- * Posesivë.
- * Duan të jenë "të zotëruar" nga partneri.

... NË DHJETOR

- * Pëlqejnë "lojën me role".
- * Argëtues.



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Si do të vjen fundi i dashurisë sonë?

Jemi dy persona që duhemi shumë. Punojmë në një zyrë. Lidhja jonë shkon mirë. Kujdesi i tij ndaj meje është aq i madh sa nuk di ta përshkruaj. Është njeriu që i kam dhënë gjithçka nga vetja...

Por, për çudi, po të mos shihemi dy-tri ditë, është shumë i ftohët ndaj meje. Nuk di çka është në pyetje...

Jemi në lidhje qe dy vjet. Unë po dua ta mbyllë këtë dashuri me fejesë, kurse ai heziton...

Kur i them se është mirë të fejohejmë, ai thotë se ende është herët...

A do të ketë fejesë ndërmjet nesh apo...

"E dua"

Përgjigje:

Ai ka dyshime për një person me të cilin ti ke punuar në po atë zyrë katër vjet rresht.

I kanë thënë se ke qenë në lidhje me të.

Andaj, është në ndjekje e sipër të fakteve

dhe unë besoj që ju disa herë e keni hapur atë temë.

Nuk do të keni fejesë dhe lidhja juaj do të zgjasë deri kah muaji qershor, kohë kur edhe do të ndaheni përfundimisht.

Pse dështoj kur ndihem mirë?

E dashura magjistare, kam një problem që mendoj se nuk e ka çdo kush. Kur e ndjej veten mirë, them: Elham Zotit, po më ecën mirë gjithçka! Por, edhe kur bëhet diçka që gëzohem, fillon çdo gjë të mbrapshtohet dhe vij në pozitë që them: Allahu xh. h. m'i largon të gjitha! Nuk di a e kam këtë mundim prej Zotit apo prej robotit? Zoti thotë se fati vjen krejt papritur dhe ashtu më ka ndodhur edhe mua.

E njoha një djalë, me të cilin çdo gjë më shkoi mirë dhe gjërat filluan të thellohen. Dhe, duke shkuar çdo ditë e më mirë, atij i vdiq një shok i ngushtë

dhe që nga ajo ditë

nisi të silltet me mua

shumë ftohët!

Gëzimi im, e që

ishte si duhet me

këtë djalë, filloi të

shndërrohet në

dëshpërim!

Shumë herë më

është paraqitur kjo

gjendje, duke u

nisur me gëzim, e

duke kaluar në pikël-

lim e dëshpërim!

Dhe, me çdo kënd

që e njoh më ndodh

kështu!

Dua të di, motër

magjistare, a do të

del hajër për mua

apo do të vazhdoj kështu, si tash, që sa herë njihem me ndokënd, ndodh diçka e po prishet puna?

"Pa shifër"

Përgjigje:

Është një thënie popullore, që ka dal nga përvoja popullore: "Mos u gëzo i gëzuar, mos u hidhëro i hidhëruar!". Këto fjalë e konceptojnë dhe e shpjegon më së miri gjendjen e ndryshimeve socio-psikike të njeriut, tek i cili ndodh kataklizëm praktik dhe shpirtëror, si në poezinë e arbëreshit, Vorea Ujko, i cili për syzhe tematik ka tri motra që presin fatin.

E, në momentin kur e pret e madhja fatin që duhej t'i vinte me agim, po atë mëngjes ajo vdes!

Edhe motra e dytë, njëjtë... E kishte kërkuar fatin dhe në vend të fatit i troket vdekja e befasishme!

Dhe, kur motra e tretë u ndikua nga kjo përvojë, duke pritur vdekjen në vend të fatit, ia behu fati dhe e bëri të lumtur...

Populli, nisur nga kjo përvojë, e ka nxjerrë urtinë që e thamë më lartë, e që dëshmon se jo gjithnjë jeta shkon sipas parashikimeve.

Jeta sjell edhe befasi e surpriza. Filozofia popullore rrjedh nga përvoja, ashtu sikur janë krijuar këngët popullore në luftë e në mjerim, në tragjedi e në mort. Pra, ajo që krijohet në zjarr mbetet për t'u kënduar e jetuar...

Por, në rastin tënd, ia vlen lufta për atë person që të ka dashur. Ai që të ka dashur, ka mundësi për të të dashur sërish. Jeni të njëjtit, të cilët dashurinë e keni hedhur në aut, shkaku i një vdekjeje. I dashuri yt më nuk e ka mikun e tij të ngushtë, andaj ka mundësi të kthehet te ti me dashuri...

Dhe, posa të kuptojë ai se jeta e ka edhe anën e dhembjes, e që është reale, edhe pse vjen papritur, do të sheh se nuk jetohej duke vuajtur e lotuar përjetësisht, por jeta vazhdon, duke shkelur nëpër lëndime dhe trauma.

Jam mirë, por jetoj me dhimbjet e përditshme!

Jam nënë. I kam dy fëmijë (22 dhe 20 vjeç). Jetoj jashtë. Jetoj me një shqetësim të përditshëm, duke më dhimbur çdo ditë diku. Mjeku më thotë se nuk kam problem. I kam bërë analizat sa e sa herë dhe çdo gjë më del mirë. E, unë përsëri nuk ndihem mirë! Djemtë i kam në rrugë të mirë, nuk

Të dashur lexues, për ata të cilët kërkojnë përgjegje nga "Magjistarja" në "Kosovare", ju lutemi, plotësoni kuponin e mëposhtëm dhe dërgoni me pyetjen tuaj në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10000 Prishtinë. Apo shkruani email, ku në subjekt shkruani kodin:MDISY2, dhe dërgoni në: lindjavdekja@hotmail.com. Përgjigjet janë pa pagesë.

PYETJEVE PA KUPON APO KOD NUK U PËRGJIGJEMI!

Emri: _____
Mbiemri: _____
Mosha: _____
Vendi: _____
Tel: _____

KUPON:

*kodi ndërrohet çdo numër.

konsumojnë as duhan e as alkool.
Pse e kam këtë problem, motër e nderuar?

“Largësia”

Përgjigje:

Ti, në fakt, nuk e ke këtë problem sot, por kështu ke jetuar që nga fëmijëria. De fakto, nuk je paciente, por nuk je edhe larg pacientes.

Nuk ke asnjë problem, por ke dhimbje që shkaktohen nga baza nervore, e që rrjedh nga e kaluara traumatike. Traumatizmi nuk shërohet posa ta kalojë njeriu kufirin e BE-së. Brezat tanë jetojnë me trauma dhe kanë nevojë t'i shërojnë traumat. Dhe, për shkak të këtyre traumatizmave, sot në botën kriminalistike ka dhjetëra vrasës serikë, që kanë kryer krime edhe nëpër spitale të reputacionit botëror, me “arsyetimin” e tmerrshëm se duhet të vriten për të mos vuajtur në klinika!

Bota traumatike vazhdon të çdo kush, kur prindi fëmijës i tregon diçka nga jeta e vet. Nuk ka shekull që nuk ka ndodhur ndonjë luftë dhe lufta e ujit tokën me gjak.

Dhe, nga gjaku krijohen legjenda e mite, e që, pastaj, për t'i demitizuar duhet kaluar breza e breza.

Në rastin tënd, nuk bën punë mjekësia e as jeta klinike, sepse kur je mirë me refleksionet mjeko-laboratorike, barërat përjashtohen si zgjidhje.

Lufta të mbetet ty, prandaj edhe ka shërim alternativ...

A është e ardhmja ime pranë burrit?

Përsëndetje zonja magjistare, jam një zonjë, 35 -vjeçare, jetoj në Prishtinë. Kam pasur probleme në jetën time. Një kohë kam qenë jashtë, por nuk kam mundur të jetoj atje. Andaj, edhe jam kthyer në vendlindje. Jam martuar në vitin 2018. Dua të di se si do e kem jetën time dhe, nëse ka mundësi më thoni diçka për të kaluarën time dhe a kam gabuar që nuk më ka shkuar mirë jeta?

“M.”

Përgjigje:

Nuk të shoh pranë burrit me të cilin je tash. Ti je martuar me të pa e shëruar plagën nga ndarja me burrin tjetër, që ke jetuar në Gjermani.

Prandaj, gabimi qëndron mu aty se, të paktën, edhe dy vjet nuk është dashur të kishit bërë martesë.

Të martohesh me një burrë, duke vuajtur për tjetrin me të cilin ke jetuar, është krim, sepse nuk e bën të lumtur as burrin e as veten.

Të vuash për dikë e ta vësh kokën në jastëk me tjetrin, është jorehabilituese. I përket, kryesisht, sjelljes shumë konservatore, për çka ke bërë hapa të nxituar, ku e ardhmja nuk mundet ta vendosë bazën e jetës bashkëshortore.

Në familje janë shumë sy që të shohin, të shikojnë. Janë shumë gojë që tregojnë se çfarë shohin në ty dhe më nuk është sekret që të të zbulojnë se ke bërë martesë për mbështetje.

E, kjo është ajo që thashë se të është dashur pushim shpirtëror, derisa ta harrosh lidhjen e parë dhe, tek pastaj, të bësh martesë.

Pra, nuk të shoh edhe gjatë kohë bashkë me të. Shoh se së shpejti do të ndaheni.

E doja burrin tim, por nuk e dua më!

Zonjë, e çmoj rubrikën tënde dhe e lexojmë e tërë familja...

Jam e martuar, e kam edhe një fëmijë tash, së voni... Por, e kam një problem që po më brengos shumë. Nuk po mund ta shoh me sy burrin tim! Nuk kam dëshirë t'ia ndijë as zërin! S'kam dëshirë të qëndroj as në shtëpi! Nuk di çka po ndodh me mua?! Por, kur ai del nga shtëpia - gëzohem dhe ndihem mirë!

Nuk ka qenë kjo gjendje nga fillimi, e as nuk kam diçka hile, as nuk e kam tradhtuar, por ja që më është fiksuar në kokë dhe nuk jam kah mundem as ta dua!

E kam dashur shumë dikur...

Po dyshoj se kemi magji, sepse nuk është asgjë në shtëpi sikur ka qenë përpara.

Të lutem, më ndihmo që të jem si dikur - ta dua burrin dhe të mund të qëndrojë pranë tij!

“D.”

Përgjigje:

E saktë: keni magji. Keni në shtëpi disa letra të mbështjella, që nuk janë kuranore. Përkundrazi, janë me disa shenja që nuk i kupton kush! E, gjërat e dyshimta nuk duhet të jenë pjesë e shtëpisë.

Ato i keni në sallonin e shtëpisë, konkretisht te sirtari i detergjenteve.

Mos i hapni e as mos i mbani në duar, por hidhni! Pra, largoni prej shtëpisë dhe kam besim se gjërat do të rikthehen në

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

drejtimin e progresit.

Kjo magji është bërë për t'ua shkatërruar martesën, sepse dikë në rrethin tuaj familjar e pengon rritja juaj familjare! Burri yt është rritur jetim dhe synimi është t'ua marrin pronat që i keni rreth autostradës...

Kam pagjumësi. Pse?

Përsëndetje zonjë, jeni e mrekulueshme! Jam E. T., 32-vjeçare.

Nuk ndihem mirë me shëndet kohëve të fundit! Kam disi zënie në gjoks dhe më vjen sikur po mbetëm pa ajër.

Ka kohë që nuk po fle mirë dhe nuk ndihem e disponuar.

Të lutem, ç'është në pyetje?

Te mjeku kam qenë dhe i kam bërë të gjitha analizat e nevojshme. Të gjitha më kanë dal mirë...

“E hutuara”

Përgjigje:

Problemi juaj është i natyrës stresore dhe lidhet me bazë nervore.

Nuk keni probleme të natyrës mjekësore dhe këtë e ka dëshmuar edhe gjendja e pasqyrës së gjakut që keni bërë.

Pagjumësia te ju është pjesë e shqetësimeve psikike. Keni frikë dhe nuk ndiheni rehat. Keni edhe depresion që u ka ardhur si pasojë e prishjes me lidhjen tënde, në pranverën e vitit që e lamë pas, meqë ke shpresuar se do të ndodhë edhe fejesa.

Ndarja u ka lënduar tej mase, sepse ua ka marrë disa vite të rinisë suaj. Ndarja u ka falë depresion, nga i cili ka filluar shumëçka e keqe te ti.

Mundohu ta harrosh! Shih fatin e ri, sado që kohën nuk e ke shumë për vete, sepse po hyn në vitin 31 të moshës, e që është vështirë të gjesh fatin që të konvenon. Por, pa marrë parasysh si janë gjërat, ti duhet të ecësh përpara, e mbushur vullnet dhe elan.

Do t'i kesh tri raste deri në fund të vitit, prandaj mos nxito, sepse për mua oferta më e mirë do të jetë ajo e mesmja, që do të të vjen gjatë verës, në kohën e ardhjes së mërgimtarëve tanë...



SHERWOOD

Resorts and Hotels

**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

www.sherwoodhotels.com.tr
+90 444 88 07